

**KONTRATË PËR HARTIMIN E AKTIT TË THEMELIMIT TË  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“A&A MANAGEMENT ” SH.P.K.**

Sot, më datë 03.04.2024 (dy mijë e njëzetë e katër), pala e mëposhtme:

1. ALKO IMPEX CONSTRUCTION shpk me NUIS K91628013D me seli në adresën Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga "Asim Vokshi", Alb building 2t, kati i 2 Tiranë përfaqësuar nga administratori dhe ortakë i vetëm Z. Arbër Abazi, mbajtës i letërnjoftimit me I61130047A madhor me zotësi të plotë për të vepruar.

ka vendosur të nënshkruajë këtë Akt Themelimi të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**A&A MANAGEMENT” SHPK**, aktiviteti i së cilës rregullohet nga ky Akt Themelimi, Statuti dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

**NENI 1  
ORTAKËT THEMELUES**

1.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar krijohet nga ortakët si mëposhtëm:

1. ALKO IMPEX CONSTRUCTION shpk me NUIS K91628013D me seli në adresën Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga "Asim Vokshi", Alb building 2t, kati i 2 Tiranë përfaqësuar nga administratori dhe ortakë i vetëm Z. Arbër Abazi, mbajtës i letërnjoftimit me nr. I61130047A madhor me zotësi të plotë për të vepruar.

**NENI 2  
BAZA LIGJORE**

- 2.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, si dhe të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar.
- 2.2 Kjo shoqëri fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



### **NENI 3 EMËRTIMI**

- 3.1 Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “A&A MANAGEMENT” SHPK.

### **NENI 4 SELIA**

- 4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Asim Vokshi, njësia bashkiake nr. 9, pallati Albuilding & 2T, kati 2 Tiranë..

### **NENI 5 OBJEKTI**

- 5.1 Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie është:

Zhvillim, ndertimi, operimi dhe administrimi në fushën e Hoteleri Turizimit dhe aktiviteteve të tjera ndihmëse të saj si dhe cdo aktivitet tjetër të lejuar në Republikëne Shqipërisë.

### **NENI 6 KOHËZGJATJA**

- 6.1 Shoqëria ka një kohëzgjatje të pacaktuar. Ajo mund të përfundojë veprimtarinë përpara këtij afati në rastet e prishjes, falimentimit ose të likuidimit të shoqërisë të parashikuara këto në legjislacionin tregtar shqiptar në fuqi..

### **NENI 7 KAPITALI THEMELTAR**

- 7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) Lekë i ndarë në 1 (një) kuotë. Çdo kuotë njësi jep të drejtën e një vote. Kapitali themeltar i shoqërisë nënshkruhet tërësisht nga Ortaku.

- 7.2 Pjesët e kapitalit të shoqërisë zotërohen nga Ortakët, si më poshtë vijon:

- **Ortaku ALKO IMPEX CONSTRUCTION shpk** , zotëron 1 (një) kuotë, të barabartë me 100 % (njëqind për qind ) të kapitalit themeltar.

### **NENI 8 ADMINISTRIMI**

- 8.1 Me këtë akt emërohet Administrator i shoqërisë:



Arbër Abazi, i biri i Sherif, lindur në datë 30.11.1986 në Tiranë e me banim në Tiranë , madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i lehtënjofimit me numër personal I61130047A

Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit, në përputhje me parashikimet e Statutit të shoqërisë dhe të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Administratori emërohet për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje.

## NENI 9 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në përputhje me ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, si dhe me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar.
- 9.2 Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statut, si dhe në legjislacionin përkatës shqiptar.
- 9.3 Ky Akt Themelimi është hartuar në Tiranë, Shqipëri, në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha fuqi të njëjtë ligjore.

## O R T A K Ë T

